UDC: 821.18-31:811.18'42

Professional paper

ILOKUCIONI NË ROMANIN „DARKA E GABUAR“ TË ISMAIL KADARESË

Nertila RAMADANI[1]

[1*] *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

[*] *Corresponding author e-mail: nertila.ramadani@unite.edu.mk*

Abstract

This study aims to explore the use of illocutionary acts in Ismail Kadare's novel The Wrong Dinner, based on Searle's theory. The significance of studying illocutionary acts lies in their direct connection to the speaker's intent during communication.

A qualitative research method is employed. The data source consists of the dialogues between the novel's characters, particularly the main characters: Dr. Gurameto and Colonel Fritz von Schwabe. The way these characters use illocutionary acts to communicate, make commitments, or declare statements reflects shifts in their moral, psychological, and social positions. The use of illocutionary acts in the novel is not limited to verbal interaction but has tangible consequences on character relationships and the development of the overall conflict.

The data analysis begins by isolating dialogues, followed by the analysis and classification of utterances into types of illocutionary acts, as well as the categorization and quantification of speech act types. This study applies pragmatic speech act theory to analyze illocutionary use in conversations (dialogues). The findings show that the novel employs five types of illocutionary acts: representatives, directives, commissives, expressives, and declaratives.

Keywords: *speech acts, illocutionary acts, illocutionary force, novel.*

Hyrje

Ky punim mëton të shqyrtojë rolin thelbësor të akteve ilokutive në romanin “*Darka e gabuar”* të Ismail Kadaresë. Aktet ilokutive janë klasifikuar dhe analizuar në bazë të teorisë së akteve të të folurit të propozuar nga Xhon Sërli. Janë shqyrtuar në mënyrë sistematike dialogët dhe sekuencat rrëfyese për të dëshmuar se thëniet nuk janë përdorur vetëm për të transmetuar informacione, por në të njëjtën kohë janë përdorur si mjete për të treguar veprim, të përshkruajnë realitetin shoqëror të kohës, ndarjen e personazheve në role etj.

Përdorimi i të gjitha akteve ilokutive: paraqitëseve, udhëzueseve, zotueseve, shprehëseve, deklarueseve dëshmon për përdorimin e shumanshëm dhe njohjen e tyre nga Kadareja, si në narrativën e rrëfimit ashtu edhe në atë të dialogut. I vlerësuar si një nga figurat më të shquara letrare në Shqipëri dhe jo vetëm, veprat e Kadaresë janë shkruar duke ndërthurur kontekstin historik, kritikën politike dhe morale të shoqërisë.

“Darka e gabuar”, e botuar në vitin 2008, është e ndërtuar përmes rrëfimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në një darkë kontroverse, “misterioze”, të organizuar nga doktor Gurametoja për oficerët nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Edhe ngjarja e këtij romani, ngjashëm me romanet tjera të Kadaresë ndodh në qytetin e Gjirokastrës. Synimi i hulumtimit është zbërthimi i shtresave kuptimore të ndërveprimeve gjuhësore përmes përdorimit të teorisë së akteve

https://doi.org/10.62792/ut.filologjia.v13.i24-25.p3029

ilokutive. Aktet ilokutive janë thelbësore për të kuptuar mënyrën se si personazhet e justifikojnë sjelljen e tyre, ndërtojnë identitetet e tyre dhe përmes gjuhës veprojnë në tërë veprën.

Pyetjet kërkimore që e shoqërojnë këtë analizë janë:

- Si përdoren aktet ilokutive nga ana e personazheve të Kadaresë për të treguar dinamikën e pushtetit gjatë dialogëve mes tyre?
- Cili është roli i akteve kumtuese indirekte (ironia, sarkazma, heshtja) në përcjelljen e kritikës politike në roman?
- Në cilat mënyra shprehjet performuese (akuzat, pohimet, mohimet) ndikojnë në narrativën dhe konfliktet në roman?

Këto pyetje kërkimore lidhen ngushtë me hipotezat kryesore të hulumtimit:

Në roman, Kadare përdor akte të tërthorta të të folurit (ironi, kërcënime, heshtje) krahas atyre të drejtpërdrejta (urdhrat, kërkesat, zotimet).

Kadare përdor heshtjen strategjike si një nënkategori të akteve të të folurit për të treguar rezistencë (shpesh personazhet refuzojnë të flasin dhe kjo heshtje ka peshë më të madhe sesa dialogu eksplicit).

Korniza teorike

Korniza teorike mbështetet në teorinë e akteve të të folurit, të propozuar nga Xhon Sërli, e cila ndërtohet mbi idetë themelore të propozuar nga mësuesi i tij, Xhon Ostini (1962). Duke u mbështetur në veprën e Ostinit, filozofi Xhon Sërl (1969) në veprën e tij "Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language" ("Aktet e të folurit: një ese mbi filozofinë e gjuhës") propozoi një taksonomi të akteve të të folurit, e cila bazohet në forcën e tyre ilokutive. Sërli kontribuoi në zgjidhjen e çështjes së komunikimit të tërthortë.

Ai pohon se, në aktet e tërthorta të të folurit, "folësi komunikon me dëgjuesin më shumë sesa thotë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u mbështetur në aktin e tërthortë të të folurit mbi informacionin e ndarë në mënyrë të ndërsjellë, si gjuhësor ashtu edhe jogjuhësor, së bashku me aftësitë e përgjithshme të racionalitetit dhe të nxjerrjes së përfundimeve nga ana e dëgjuesit" (Searle, 1979: 30–31). Aktet e të folurit, të propozuara nga ai janë:

Paraqitëset janë akte ilokutive në të cilat folësi pohon se diçka është e vërtetë ose e pavërtetë. Forca ilokutive e këtyre akteve të të folurit është pohuese: folësi dëshiron ta bindë dëgjuesin për vërtetësinë e asaj që po thotë (Kusevska, Buzharovska, 2020:113). Funksioni parësor i tyre është të transmetojnë informacione ose të shprehin një pohim dhe të konfirmojnë vërtetësinë e atij pohimi.

Udhëzueset janë ato lloje të akteve të të folurit që folësit i përdorin për të nxitur dikë tjetër të bëjë diçka. Ato shprehin atë që dëshiron folësi (Yule, 1996:53). Udhëzueset paraqesin dëshirën e folësit që dëgjuesi të ndërmarrë një veprim të caktuar.

Në gjuhësi **zotueset** janë një lloj akti i të folurit, me anë të së cilave folësi merr përsipër të bëjë diçka në të ardhmen (premtime, kërcënime apo paralajmërime). Zotueset karakterizohen nga ndonjë angazhim ose ndërmarrje veprimi; ato e obligojnë folësin të ndërmarrë një veprim, por përfshijnë gjithashtu deklarata ose shprehje të qëllimit që nuk janë domosdoshmërisht premtime, si dhe disa shprehje të paqarta që mund të quhen "betime" (espousals), si për shembull, mbështetja (Austin, 1962:150).

Shprehëset janë fjali ose fraza që përcjellin gjendjen emocionale ose qëndrimin e folësit ndaj diçkaje. Ato përdoren shpesh për të shprehur ndjenja, si: gëzim, zemërim, frustrim, habitje, mosbesim dhe emocione të tjera.

Shprehëset janë ato lloje të akteve të të folurit që tregojnë se çfarë ndien folësi. Ato shprehin gjendje psikologjike dhe mund të përfshijnë deklarata të kënaqësisë, dhimbjes, pëlqimit, mospëlqimit, gëzimit ose trishtimit (Yule, 1996:53).

Deklarueset janë shprehje që përcjellin informacion ose japin pohime mbi një temë të caktuar. Ato janë fjali përmes së cilave deklarohet ndonjë fakt ose mendim. Fjalitë deklarative

zakonisht mbyllen me pikë dhe mund të jenë pozitive ose negative. Rastet paradigmatike përfshijnë arritjen e marrëveshjeve të caktuara, shpalljen e luftës, ekskomunikimin, shkarkimin nga puna dhe emërimin e një kandidati (Huang, 2015:134).

Metodologjia

Të dhënat që janë pjesë e analizës përfshijnë dialogët, bisedat dhe segmentet narrative që shprehin forcën ilokutive. Fillimisht janë veçuar bisedat në të cilat është vërejtur ekzistenca e konflikteve të brendshme ndërmjet personazheve. Pjesa më e madhe e tyre përfshijnë gjuhën e përdorur nga dr. Gurametoja i madh dhe dr. Gurametoja i vogël, si dhe përshkrimet e autorit mbi mendimet e oficerëve gjermanë dhe banorëve lokalë. Më pas çdo pohim është kategorizuar duke përdorur tipologjinë e lartpërmendur të propozuar nga Sërli.

Në rastet kur në një pohim janë përdorur më tepër funksione (akte të të folurit) është identifikuar dhe përshkruar forca kryesore ilokutive. Punimi bazohet kryesisht në metodat kualitative dhe interpretuese, të cilat janë format më të përshtatshme të analizave pragmatike në tekstet letrare. Qasja kualitative lejon interpretimin e thelluar të elementeve gjuhësore dhe stilistike, ndërsa ajo interpretuese ndihmon në analizën e gjuhës së përdorur gjatë komunikimit të personazheve dhe ndërtimin e subjektit.

Analiza dhe diskutime

PARAQITËSET

Në letërsi, aktet kumtuese, përfshirë këtu aktet paraqitëse (pohuese) shërbejnë për të shprehur bindjen e folësit dhe angazhimin e tij për pohimin e së vërtetës. Gjatë përdorimit në tekstet letrare, këto akte shfaqen në funksione të shumëfishta: të informojnë, të ndërtojnë personazhe, përdoren në ndërtimin dhe zhvillimin e ngjarjeve, rrëfimit etj. Në romanin "Darka e gabuar" vërehet përdorim i dendur i paraqitëseve, të cilat në pamje të parë duken si të thjeshta dhe të zakonshme, por gjatë analizës vërehet se janë të ndërlikuara, të ngarkuara me kuptime të shumëfishta, shpesh edhe të ndërlidhura me akte tjera ilokutive.

Analiza e akteve paraqitëse është e rëndësishme për të kuptuar si autori krijon lidhje mes të thënës dhe të nënkuptuarës, mes historisë së shkruar dhe asaj të njohur. Në vijim do të pasqyrojmë dhe analizojmë disa nga modelet e akteve paraqitëse të përdorura në roman, për të analizuar qasjen pragmatike dhe ndikimin e tyre në narracionin e veprës, i cili është shpesh i tensionuar, i mbushur me të vërteta dhe dilema historike.

1 "Asnjë shenjë smire nuk ishte shfaqur kurrë midis doktor Gurametos së madh dhe doktor Gurametos së vogël." (Kadare, 2008:7)

2 "Italia kishte kapitulluar, këtë s'kishte njeri që s'e dinte."(Po aty:11)

3 "Gjermania nuk po e pushtonte, por po kërkonte kalim në Shqipëri." (Po aty:12)

4 "Për mendjemadhësinë e pafre të këtij qyteti kishte shpjegime të ndryshme." (Po aty:15)

5 "Në këtë pikë, bashkë me shpirtrat, zërat ligështoheshin." (Po aty:23)

6 "Ishte era e shtatorit, pra, ajo që, pasi kishte gufmuar perden e bardhë të njërës prej dritareve të lëna hapur..." (Po aty:26)

7 "Pasdite. Pjesa e dytë e ditës. Pjesa e pasme e saj." (Po aty:28)

8 "Ndonëse as që mund të përfytyroheshin gjëra më të largëta se ai shesh i zi..." (Po aty:34)

9 ".....ai ia nguli vështrimin pamjes, në një mënyrë që i habiti të tjerët." (Po aty:40)

10 " Megjithatë, njëri nga lajmet s'ndryshonte: Pengjet po liroheshin vërtet." (Po aty:58)

11 "Askush nuk do ta besonte se tërheqja e ushtrisë gjermane... do të ngjante kaq e rëndomtë." (Po aty:87)

12 “Flamuri ishte prapë me shkabë, por ajo s'ishte me tre krerë, siç ishte folur, por me dy, si dikur.” (Po aty:90)

13 “Darka e famshme me gjermanët pothuajse askush s’e zinte ngoje.” (Po aty:98)

14 “Në ditën e pesëqindtë, në këmbët e qytetit u shfaq ajo që s'duhet të shfaqej kurrë: vargani i parë i çamëve të shpërngulur.” (Po aty:101)

15 “Vëllai, Ali Tepelena, që nga kulla e tij, me tejqyrën e gjatë të oficerit, ndiqte ecjen e saj.” (Po aty:130)

16 “Frymëmarrja e lehtësuar e doktorëve nuk u shoqërua me zbutje të vështrimit nga pala tjetër.” (Po aty:132)

17 “Në fytyrën e doktor Gurametos nuk lëvizi asgjë.” (Po aty:143)

18 “Hetimi, pa dashur, po kthehej në qerthull të mbyllur.” (Po aty:165)

19 “Ata të gjithë janë tani nën dhe.”(Po aty:170)

20 “Lajmi i vdekjes u dha pak para mesditës.” (Po aty:193)

21 “Në të dalë të pranverës, u bë gjyqi i dy hetuesve.” (Po aty:201)

22 “Trupi i Gurametos së vogël, me gjithë kërkimet e pareshtura, nuk u gjet, gjithashtu, kurrë.” (Po aty:202)

23 “Zhvarrimi i eshtrave ndodhi dyzet vjet më pas, në shtator të vitit 1993, fill pas rënies së komunizmit.” (Po aty:202)

24 “Pesëmbëdhjetë vjet më pas, në pranverën e vitit 2007, kur Bashkimi Europian i kërkoi Shqipërisë... dosja e doktor Gurametos së madh u hap përsëri.” (Po aty:203)

Këto njësi gjuhësore formalisht paraqiten si deklarata të thjeshta, faktike, por në vetvete përmbajnë elemente të rëndësishme narrative, ideologjike, ekzistenciale. Në roman aktet paraqitëse shfaqen si mjete informimi, vlerësimi dhe ndërtimi i dialogut dhe narracionit. Për shembull në pohimin “Asnjë shenjë smire nuk ishte shfaqur kurrë midis doktor Gurametos së madh dhe doktor Gurametos së vogël” vërehet funksioni përshkrues dhe informues, i cili vë në pikëpyetje konkurrencën dhe harmoninë mes dy protagonistëve.

Shprehjet “Gjermania nuk po e pushtonte, por po kërkonte kalim në Shqipëri” ose “Italia kishte kapitulluar, këtë s'kishte njeri që s'e dinte”, janë pohime që përshkruajnë një realitet historik dhe politik. Disa akte kanë funksion interpretues ose korrigjues, të cilat qartësojnë realitetet e dyshimta si: “Flamuri ishte prapë me shkabë, por ajo s’ishte me tre krerë, siç ishte folur, por me dy, si dikur”. Një numër pohimesh janë të përmbushura me elemente poetike, emocionale, të ndjeshme, atmosferë që lidhen me faktorin kohë: “Në këtë pikë, bashkë me shpirtrat, zërat ligështoheshin” dhe “Pasdite. Pjesa e dytë e ditës.

Pjesa e pasme e saj”. Ka pohime që ndërtojnë karaktere historike dhe situata simbolike, si “Vëllai, Ali Tepelena, që nga kulla e tij, me tejqyrën e gjatë të oficerit, ndiqte ecjen e saj”, ndërkohë që disa prej tyre funksionojnë si deklarata me ngarkesë sociale, historike dhe emocionale p.sh. “Darka e famshme me gjermanët pothuajse askush s’e zinte ngoje” dhe “Në ditën e pesëqindtë, në këmbët e qytetit u shfaq ajo që s’duhet të shfaqej kurrë: vargani i parë i çamëve të shpërngulur”. Përmes këtyre akteve Kadare ka ndërtuar strukturën narrative, e cila flet për të thënat e të pathënat, për faktet, kujtesën dhe kthesat, manipulimet historike.

UDHËZUESET

Është e njohur se Kadare në veprat e tij ka ndërtuar një lloj narrative të ndryshme nga ajo tradicionale. Përmes akteve udhëzuese ai ka ndërtuar dialogun, rrëfimet ideologjike, psikologjike, shpesh tensionuese. Frazat urdhëruese, kërkuese, paralajmëruese, që janë paraqitur në roman dhe në vazhdimësi, nuk janë thjesht forma gjuhësore, por bartëse të kuptimeve politike dhe ekzistenciale.

1 “....dil e më prit e mos dëgjo ç'thonë për mua e as topat e tanket, që kam me vete, mos m'i shih.....” (Po aty:13)

2 “Në trakte bëhej thirrje për luftë dhe vetëm për luftë.” (Po aty:14)

3 “Jepmë mua Kosovën e Çamërinë, jawohl!” (Po aty:20)

4 “Rri aty. Vritu, pritu, siç the, por mos ia mbath!” (Po aty:22)

5 “Liroji pengjet, Fritz!” (Po aty:52)

6 “Më jep fajtorët, të të jap pengjet!” (Po aty:54)

7 “Nga kjo përkitje, të dyja ndryshonin prore, gufoheshin, treteshin e shtrembëroheshin.” (Po aty:58)

8 “ Megjithatë, njëri nga lajmet s'ndryshonte: pengjet po liroheshin vërtet.” (Po aty:58)

9 “ Zëra të ulët dëgjoheshin gjithkund: Kujdes, mos bëni zhurmë e hare se s'i dihet ç'ndodh.” (Po aty:59)

10 “Historia e nofkave, ndonëse e re në krahasim me atë të pengjeve, nuk ishte më pak e larmishme.” (Po aty:60)

11 “Stop! Halt” (Po aty:63)

12 “Na fal për gabimin, doktor.” (Po aty:91)

13 “Mos shqyeni sytë sikur paskeni zbuluar ndonjë enigmë.” (Po aty:97)

14 “Përgatituni për më të zezën.” (Po aty:109)

15 “Do të vish nesër në mbledhje?” (Po aty:113)

16 “Në doni ta gjeni fajin, hetoni te Kadarenjtë e tjerë, ata të Palortosë.” (Po aty:125)

17 “ Ata që i dëgjonin u thoshin: ju qenkeni të lajthitur, por këta u përgjigjeshin: Prisni, prisni, ta shihni ç'do të bëhet.” (Po aty:127)

18 “Fol!”(Po aty:149)

19 “Trego!” (Po aty:150)

20 Mos u habitni aspak, tha rusi.” (Po aty:157)

21 “I thoni, për shembull, frazën: 'Unë s’jam Shqipëria, ashtu si ti s’je Gjermania, Fritz... Ne jemi tjetër gjë…” (Po aty:163)

22 “Ti ke në dorë ta shërosh Stalinin.” (Po aty:184)

23 “Ngjalle Stalinin së vdekurish!” (Po aty:185)

24 “Mos hiq dorë, i thoshte vetes!” (Po aty:191)

25 “Mbaroi!” (Po aty:193)

26 “Ngrihu, të keqen nëna... Mbaroi...” (Po aty:193)

27 “Po qesh, eh?” (Po aty:197)

28 “Ku është tjetri?” (Po aty:197)

29 “Lidheni te pranga e djathtë!” (Po aty:198)

30 “Mos më merr në qafë, shef!” (Po aty:198)

Fjalitë si: “...dil e më prit e mos dëgjo ç'thonë për mua...” dhe “Rri aty. Vritu, pritu... por mos ia mbath!” paraqesin akte direktive, që mbartin ngarkesë të lartë emocionale. Një pjesë e këtyre frazave, si “Jepmë mua Kosovën e Çamërinë, jawohl!” apo “Ngjalle Stalinin së vdekurish!”, shfaqin ironinë dhe groteskun në nivel simbolik, përplasin absurditetin e kërkesave me pamundësinë politike dhe realitetin historik. Pohimet e përsëritura si “Liroji pengjet, Fritz!” dhe “Më jep fajtorët, të të jap pengjet!” ndërtojnë kontekst komunikimi, në të cilin palët e kushtëzojnë njëri – tjetrin dhe janë në garë me kohën dhe qëndrime reciproke.

Urdhrat e drejtpërdrejtë si “Stop! Halt!”, “Fol!”, “Trego!”, “Lidheni te pranga e djathtë!”, “Ngrihu, të keqen nëna...” dhe “Mos hiq dorë, i thoshte vetes!” e përforcojnë autoritetin, nënshtrimin e personazheve në kufijtë e durimit dhe identitetit. Përdorimi i shprehjeve të tilla si “Na fal për gabimin, doktor.” dhe “Mos më merr në qafë, shef!” paraqesin hierarkinë e personazheve. Në raste të tjera, frazat marrin karakter ndërveprues e hetues si “Ku është tjetri?”, “Po qesh, eh?” apo “Do të vish nesër në mbledhje?”.

Këto shprehje shfaqin jo vetëm tensionin, por edhe gjendjen e trysnisë shoqërore dhe frikës. Fraza përmbyllëse “Mbaroi!” shërben si një akt final që paralajmëron fundin jo vetëm të një ngjarjeje, por edhe të një periudhe, të një epoke ideologjike dhe të një rendi narrativ. Parë

në përgjithësi, të gjitha këto akte të të folurit, që përfshijnë urdhra, lutje, thirrje, paralajmërime dhe dialogë të koduar, krijojnë një mozaik të pasur komunikimi, i cili mbart jo vetëm narracionin e ngjarjeve, por edhe dramën kolektive të një shoqërie të shtypur.

ZOTUESET

Në teorinë e akteve kumtuese, zotueset janë një kategori e veçantë, si forma përmes së cilave folësit angazhohen të kryejnë ndonjë veprim në të ardhmen. Zotueset përfshijnë premtime, kërcënime, betime, marrje vendimesh, gjegjësisht folësi merr përsipër përgjegjësi me pasoja të qarta për dëgjuesin. Në roman, këto akte nuk janë vetëm deklarata për të ardhmen, por edhe dëshmi të një lufte të brendshme midis njeriut dhe sistemit, të vërtetës dhe ideologjisë. Në vijim janë të listuara një pjesë e akteve zotuese të përfshira në roman, për të pasqyruar përfshirjen e tyre në rrëfim:

1 "Gjermania sillte Kosovën e Çamërinë..." (Po aty: 20)

2 "Qyteti i vjetër kishte goditur pararojën e ushtrisë gjermane. Ai do të ndëshkohej sipas ligjeve të luftës..." (Po aty: 24)

3 "Dhe ja tani, hakmarrja e Gurametos së madh. Më harruat, hë? Tani do t'më shihni..." (Po aty: 31)

4 "Të jap fjalën se do të vij." (Po aty: 46)

5 "Në qoftë se qyteti nuk m'i jep emrat, jepmi ti." (Po aty: 55)

6 "Për askënd s'kishin bërë kaq! Mjaft!" (Po aty: 63)

7 "Kjo është, histori e vjetër qysh nga koha e asiro-babilonasve." (Po aty: 97)

8 "Në ditën e pesëqindtë në këmbët e qytetit u shfaq ajo që s'duhet të shfaqej kurrë." (Po aty: 101)

9 "Guva e Shanishasë do të hapej." (Po aty: 123)

10 "Puna do të vejë më larg e më thellë." (Po aty: 127)

11 "Ne kemi vetëm një pyetje. Ajo është e thjeshtë, por themelore." (Po aty: 132)

12 "Ne do t'ju pyesim për tjetër gjë." (Po aty: 134)

13 **"Në seancën më të parë do të vinin në provë çiltërsinë e të burgosurve, sidomos të Gurametos së madh." (**Po aty**: 156)**

14 "Ai vetë do ta ndiqte nga vrima e murit, pikërisht prej asaj, prej së cilës Ali Pashë Tepelena kishte përgjuar net me radhë torturimin e përdhunuesve të motrës së tij." (Po aty: 158)

15 "Ne mund të gjenim rrugën më të shkurtër. Të të dënonim sa hap e mbyll sytë." (Po aty: 173)

16 "Bota është përmbysur." (Po aty: 199)

Secila nga frazat e lartshënuara është më tepër se thjesht komunikim, janë akte të të folurit, që ndikojnë drejtpërdrejt në rrjedhën e ngjarjeve, marrëdhëniet e personazheve dhe strukturën narrative të romanit. Përmes analizës së këtyre akteve synohet të zbulohet mënyra si përdoret gjuha nga ana e personazheve, si mjet për të ndërtuar apo rrëzuar identitetin e tyre dhe të të tjerëve. Nga shembujt vërehen laryshi aktesh të përdorura, nga premtimet e thjeshta, kërcënimet, zotime, paralajmërime etj. Kështu shprehja "Të jap fjalën se do të vij" paraqet premtim të qartë, të drejtpërdrejtë dhe përpjekje për të ndërtuar besim.

Frazat "Tani do t'më shihni"; "Në qoftë se qyteti nuk m'i jep emrat, jepmi ti" paraqesin kërcënime, veprime të mbushura me mllef, hakmarrje, drejtuar ndaj personazheve dhe historisë njëkohësisht. "Puna do të vejë larg e më thellë" – paraqet paralajmërim me përmbajtje zotuese. Parë në përgjithësi zotimet nuk janë gjithmonë të sinqerta, por paraqesin maska, strategji, që i japin gjuhës së Kadaresë filozofi dhe etikë njëkohësisht.

SHPREHËSET

Në vazhdën e akteve kumtuese, vend të veçantë zënë edhe shprehëset, të ndërtuara përmes frazave të shkurtra ekspresive, që shërbejnë si ndërtuese të stilit dhe tematikës së veprës. Në roman, shprehëset janë më shumë se thjesht shprehje idiomatike, frazeologjike, ato përdoren për të pasqyruar emocionet, konfliktet e brendshme të personazheve, dilemat etj. Këto akte janë shprehur përmes sharjeve të drejtpërdrejta dhe spontane, dyshime, kujtime, përmes të cilave e kuptojmë botën e personazheve: çfarë thonë, si ndihen, çfarë mendojnë, si veprojnë... Disa nga këto fraza të shkurtra me mesazhe të fuqishme janë radhitur më poshtë:

1 "Një dorë e fshehtë i kishte sjellë punët në atë farë mënyre..." (Po aty: 7)

2 "Njerëzit s'po u besonin syve." (Po aty: 12)

3 "Gjirokastrës i binte që, më seriozisht se të tjerët, të merrej me ta." (Po aty: 14)

4 "Nga të gjitha hamendjet ndodhi ajo më e keqja." (Po aty: 21)

5 "Burrave s'u mbetej gjë tjetër veç të kthenin kryet mënjanë, për të mos ia plasur vajit bashkë me gratë, që si gra që ishin, qanin ndërkaq." (Po aty: 23)

6 "Kështu që askush jo vetëm dora, por as dritarja, madje, as shtëpia ku ishte tundur coha e bardhë nuk mund të dëshmohej kurrë." (Po aty: 27)

7 "Ishte e vërtetë se shtëpia e doktor Gurametos së madh ndriçonte dhe gjëmonte nga festa..." (Po aty: 34)

8 "Mallëngjimi për të nuk mbahej dot." (Po aty: 37)

9 "Jakoelit i vjen të qajë, por as lot s'ka." (Po aty: 66)

10 "Dhe kjo vazhdon gjatë, shumë gjatë, në pritje të breshërisë së mitralozave." (Po aty: 66)

11 "Na fal për gabimin, doktor, tha me zë të qetë." (Po aty: 91)

12 "Një mut të kapa, tha tjetri." (Po aty: 95)

13 "Ah, sa bukur!" kishte thënë Marie Turtulli. "Sa prekëse këto kujtime." (Po aty: 100)

14 "Shoqe!" (Po aty: 114)

15 "Naivët zinin kryet me duar, gratë qanin..." (Po aty: 127)

16 "Ah, ajo darkë..." (Po aty: 134)

17 "Unë kam nevojë të fle, shtoi pas pak. Ju lutem." (Po aty: 144)

18 "Herr Gurameto, nuk kam bërë dy mijë kilometra fluturim ajror për të dëgjuar përçartje në një shpellë të mesjetës." (Po aty: 149)

19 "S'di ç'të them." (Po aty: 150)

20 "Për besë, edhe këtë e ditka, murmuriti Arian Ciu." (Po aty: 158)

21 "Bravo! Shkëlqyeshëm!" (Po aty: 166)

22 "E pabesueshme, klithin gati në një gojë." (Po aty: 167)

23 "Dreq, tha prapë me vete Shaqo Mezini." (Po aty: 175)

24 "Ju ishit gjithkund. Si mortja." (Po aty: 177)

25 "U gëzove, he? Tha Shaqo Mezini. E dëgjove që Stalini është sëmurë dhe u gëzove, qen!" (Po aty: 183)

26 "Ti s'mund të gëzohesh kur dikujt i merret fryma, apo jo?" (Po aty: 184)

27 "Së paku ta dija ç'kishte." (Po aty: 188)

28 "Mos, klithi me vete, duke mbuluar ballin me dorë, si të ishte verbuar." (Po aty: 185)

29 "Po të ishte i famshëm, natyrisht që gjithçka do të ishte ndryshe." (Po aty: 190)

30 "Ai shkundi kryet. Ajo çka iu kujtua ishte e papritur, befasisht mizore." (Po aty: 195)

31 "Gjoksi i dhembi fort, thua se klithma e mbytur qenkësh më çjerrëse se ajo që dilte." "Stalini s'ishte më në këtë botë. E, si të mos mjaftonte kjo, Gurametoja ishte." (Po aty: 196)

32 "Në këtë botë pikëllimtare, vetëm për vetëm me përbindëshin." (Po aty: 196)

Përmes shprehëseve, Kadare ndërton një gjuhë të dytë, të nënkuptuar, të mbushur me ironi dhe emocione, frikë dhe urrejtje. Frazat si "Njerëzit s'po u besonin syve" apo "Ah, ajo darkë…" paraqesin një lloj habie, dyshimi, nostalgjie apo frike. Shprehja "Ju ishit gjithkund. Si

mortja.” përmban tension, mbikëqyrje, përndjekje. “Naivët zinin kryet me duar, gratë qanin...” kjo shprehje paraqet përshkrim të gjendjes shpirtërore kolektive. Tjetër element kyç është ironia, e shprehur përmes personazheve në frazat “Bravo! Shkëlqyeshëm!”. “Një mut të kapa” është një shprehje e drejtpërdrejtë e dëshpërimit dhe zhgënjimit, një çast kur personazhi humbet kontrollin dhe nxjerr një të vërtetë të papërpunuar.

DEKLARUESET

Në bazë të teorisë së akteve të të folurit, deklarueset paraqesin pohime që shprehin fakte, gjykime ose besime. Këto deklarata herë kanë kuptim të drejtpërdrejtë e herë simbolik. Deklaratat shpesh shprehen me ton të qetë, shprehin mendime apo fakte e përmes tyre ndërtohet rrëfimi dhe dialogu i personazheve. Disa deklarata kanë funksion të shprehin lidhje të fortë të personazheve me atdheun dhe të shkuarën si p.sh. shprehja “Paktin tim me qytetin e kam shpallur”.

1 “Shqipëria kishte dy qëndrime.” (Po aty: 14)

2 “Ajo po hynte si mike.” (Po aty: 12)

3 “Pengjet po liroheshin.” (Po aty: 37)

4 “Kjo ishte 'darka e turpit' për disa, e për të tjerë, 'darka e ringjalljes'.” (Po aty: 39)

5 “Tetëdhjetë pengje do ta lajnë atë gjak.” (Po aty: 50)

6 “Koloneli u përgjigj se portat, si në çdo ndëshkim, zgjidheshin rastësisht: një në dhjetë.” (Po aty: 54)

7 “Paktin tim me qytetin e kam shpallur.” (Po aty: 55)

8 “Kishin shtuar se fisnikëria gjermane... kishte kufi.” (Po aty: 63)

9 “Jo një pjesë, por krejt.” (Po aty: 67)

10 “E ulën flamurin me kryq të thyer, ndërsa e lanë në vend tjetrin, flamurin vendas, me shkabën e vetmuar midis.” (Po aty: 88)

11 “Donin të arrestonin dy nga të sëmurët e operuar, njërit prej të cilëve ende s'i kishte dalë narkoza.” (Po aty: 92)

12 “Merrej me mend që nuk u harrua as doktor Gurametoja tjetër....” (Po aty: 100)

13 “.....ato ishin fytyra e fshehtë e qytetit, shpirti dhe dyzimi i tij.” (Po aty: 112)

14 Prej tyre, Prijsi, ndonëse i prerë ne fytyrë nga ankthi i rrëzimi, kishte dalë fitimtar. (Po aty: 117)

15 “Grupi i mjekëve, i drejtuar nga qendra hebraike 'Xhons', përgatitej të kryente krimin më të madh në historinë e njerëzimit...” (Po aty: 128)

16 “Kjo që sapo thatë ju, nuk është e vërtetë, tha gjermani.” (Po aty: 143)

17 “Komandanti gjerman, koloneli Fritz von Schwabe, që ju ngulni këmbë se e keni takuar më 16 shtator të vitit 1943, në tokën shqiptare, nuk ka qenë aty ku thoni ju.” (Po aty: 143-144)

18 “....koloneli Fritz von Schwabe, pas plagëve të rënda, kishte vdekur në një spital fushor të Ukrainës, më 11 maj 1943, pra, katër muaj para pushtimit të Shqipërisë.” (Po aty: 144)

19 “Hetuesit vështronin të çmeritur, pa e fshehur adhurimin.” (Po aty: 157)

20 “Kjo seancë hetimi do të ishte vendimtare.” (Po aty: 158)

21 “Darka fsheh një mister.” (Po aty: 170)

22 “Në orën tre të mëngjesit dhanë urdhër që i burgosuri të vihej në torturë.” (Po aty: 177)

23 “Të gjithë në detyrë.” (Po aty: 181)

24 “Gjetën midis tyre 'Vajzën dhe Vdekjen' e Shubertit...” (Po aty: 192)

25 “Në të dalë të pranverës, u bë gjyqi i dy hetuesve.” (Po aty: 201)

Në roman deklaratat kanë funksion të dyfishtë: ato nuk janë thjesht fjali të zakonshme që tregojnë informacion, por mënyra veprimi si tentativë për të përmbysur realitetin. Deklaratat e personazheve në roman lidhen me pasoja te ngjarjet, mënyra si kuptohet e vërteta. Fraza “Shqipëria kishte dy qëndrime” paraqet një deklaratë që përpiqet të legjitimojë kontrollin dhe

përçarjen, nënkupton ndarje politike e morale. **"Tetëdhjetë pengje do ta lajnë atë gjak."** është shembull tipik i mënyrës se si deklaratat në roman shpesh shërbejnë si vendime gjyqësore. Deklaratat e tilla si **"Komandanti gjerman [...] nuk ka qenë aty ku thoni ju"** ose **"Koloneli [...] kishte vdekur në Ukrainë, më 11 maj 1943"**, nuk janë thjesht pohime informative, por janë akte të qarta që tentojnë të fshijnë historinë, të ndryshojnë rrëfimin e përjetuar nga protagonistët.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se shumë deklarata ndodhin në kontekste zyrtare – në hetuesi, në seanca, në raportime. Kjo nënkupton se pohimet janë të lidhura me pushtetin dhe ndikojnë në rrjedhën e ngjarjeve. Për shembull, shprehja: **"Kjo seancë hetimi do të ishte vendimtare"** tregon se çdo deklaratë që jepet, është një lëvizje në lojën politike të mbijetesës ose të zhdukjes. Si përfundim, aktet deklaruese në roman janë shumë më tepër se fjali. Ato janë mjete për të shpallur të vërtetën, për të ndërtuar mite, për të fshehur krime apo për të urdhëruar ndëshkime. Ato funksionojnë si veprime: japin dënime, shkruajnë histori, e bëjnë lexuesin të shohë përtej asaj që është e shkruar.

Përfundimi

Analiza e romanit "Darka e gabuar" bazuar në teorinë e akteve të të folurit e veçanërisht të akteve ilokutive si dhe pasqyrimi i numrit të madh të shembujve të këtyre akteve, është dëshmi se gjuha e romanit nuk është thjesht përshkruese, narrative, që vetëm shpreh informacion, por është mjet që përdoret nga autori për të vepruar, për të krijuar marrëdhënie mes personazheve. Është vërtetuar se Kadare ka përdorur me mjeshtëri të gjitha llojet e akteve ilokutive: paraqitëset, udhëzueset zotueset, shprehëset, deklarueset, të cilat shpesh nuk janë të drejtpërdrejta, por janë të tërthorta, të ndërthurura me ironi, frikë, metafora.

Analiza e akteve ilokutive në letërsi është e lidhur ngushtë me analizën semantike të gjuhës, sepse janë të mbushura me nëntekste, të cilat lexuesi duhet t'i deshifrojë dhe t'i interpretojë për të kuptuar qëllimin e tekstit. Gjatë analizës duhet pasur parasysh edhe aspekti pragmatik, mënyra si këto akte vendosen drejtpërdrejt në komunikimin dhe veprimin mes personazheve. Në tekst ato janë të shpërndara në formë mozaiku, të cilat lexuesi duhet t'i përkapë, t'i sistemojë për të zbuluar drejt bindjet, mesazhet e fshehura, ideologjinë e shkrimtarit.

Referencat

[1]. Allott, N. (2010). *Key terms in pragmatics*. https://uogbooks.files.wordpress.com/2014/10/key-terms-in-pragmatics-by-nicholas-allott.pdf

[2]. Alston, W. S. (2000). *Illocutionary Acts and Sentence Meaning*. Ithaca: Cornell University Press

[3]. Austin, J. L. (1962). *How to do things with words*. Clarendon Press.

[4]. Huang, Y. (2015). *Pragmatics* (2nd ed.). Oxford University Press.

[5]. Kadare, I. (2008). *Darka e gabuar* (J. Hodgson, Trans.). Onufri. (Original work published in Albanian)

[6]. Kusevska, M., & Buzharovska, E. (2020). *Pragmatika: Jazik i komunikacija*. Ars Libris.

[7]. Searle, J. R. (1979). *Expression and meaning: Studies in the theory of speech acts*. Cambridge University Press.

[8]. Yule, G. (1996). *Pragmatics*. Oxford University Press.